



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr.100. Datë 03.02.2009**

**Mbi hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit të realizuar  
nëpërmjet shitblerjes të 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine  
MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar    |
| ▪ Zt. Lush Perpali         | Zv/kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Anëtar     |
| ▪ Zt. Koço Broka           | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 03.02.2009, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit nga përftimi i kontrollit të plotë të shoqërisë Albania AirLines MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group shpk, nëpërmjet blerjes së kuotave.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti neni 59 “Procedura në mungesë njoftimi”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe informacionit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut, të siguruar nga palët pjesëmarrëse në transaksionin e realizuar për përfitim të kontrollit të plotë në shoqërinë Albania AirLines MAK Shpk

## **V Ë R E N S E:**

- Shoqëritë Albania AirLines MAK Shpk dhe Advanced Construction Group Shpk në datën 04 Korrik 2008<sup>(1)</sup>, kanë nënshkruar një marrëveshje me objekt shit-blerje kuotash.
- Ky transaksion, në kuptim të nenit 10, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, konsiderohet përqendrim.
- Transaksioni përmbush edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit dhe si rrjedhim duhet të njoftohej në Autoritetin e Konkurrencës, në afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
- Blerësi, shoqëria Advanced Construction Group Shpk, nuk ka respektuar procedurën e njoftimit të përqendrimit

## **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 59 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

## **VENDOSI:**

1. Të hapë me nismën e vet procedurën e kontrollit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes të 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Shpk nga shoqëria Advanced Construction Group Shpk.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Lush Perpali**

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**

<sup>1</sup> Sipas marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve të noterizuar